

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm-Penal,** Gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit A.K.nga fshati B., Komuna e P.1, për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 5865/13, të datës 28.10.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 26.07.2018, në prezencën e Prokurorës së Shtetit Rukije Sheshivari, të akuzuarit A.K., e me dt:27.07.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari: A.K.**, nga i ati R., dhe e ëma H., e gjinisë K., i lindur me dt:..., me vendbanim në fshatin B., Komuna e O., me numër personal ..., i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, pensionist, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse,** Më dt. 22.07.2013, në shtëpinë e tij në fshatin B. Komuna e P., i pandehuri ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, ku në njehsorin elektrike me nr. 14068657, ka këputur pllombën distributive me nr.D100002324, të cilën e kanë vendosur personat e autorizuar të K., me ç'rast të dëmtuarës K. D. në P.2 i ka shaktuar dëm material,-

**-me këtë ka kryer veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së.**

Andaj, gjyqtari i vetëm, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4,7, 49, 51,52, 73 të KPRK-së, si dhe nenet 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i shqipton,

### DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin **A.K.** e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) Muaj, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

**Obligohet** i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor do të paguaj shumën prej 25 (njëzet e pesë) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

**E dëmtuara:** K. D. në P., udhëzohen që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 5865/13, të datës 28.10.2013, kundër të akuzuarit A.K.nga fshati B., Komuna e P.1 për shkak të veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 26.07.2018, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata i ka mundësuar të pandehurit pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pasi që në fillim të shqyrtimit fillestar, i pandehuri në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, ka pranuar fajësinë për veprën penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, gjykata në rastin konkret, pas marrjes së mendimit nga Prokurori i Shtetit, i cili është deklaruar që të aprovohet pranimi i fajësisë nga i pandehuri dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 1, nën – par. 4 të KPPRK-së, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimi të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që për të akuzuarin Azem Krasniqi, si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, ka shpreh keqardhje ka premtuar se nuk do ta përsëris asnjëher, i takon moshës së shtyer, - penzioner, ndërsa rrethana veqanarisht rënduese nuk gjeti, dhe nisur nga të gjitha këto të thëna gjykata i shqiptoi dënim me kusht me bindje se në rastin konkret është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me dënim me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi me kusht shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2 të KPRK-së, me shkallën dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 248 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Penal

P.nr.3769/2013, dt.27.07.2018

**Zyrtare Ligjore**

Dafina Ymeri

**Gjyqtari**

Kujtim Krasniqi

#### UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.